



Titulli i projektit

Krijimi i Kompleksit Sportiv - Manzë

Tipi i projektit

Zhvillim ekonomik/Kohezion Social

Vendndodhja e projektit

Manzë

Buxheti i paravlerësuar

35,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Bashkia e Manzës është e vetmja që ka të përgatitur një Plan Zhvillimi Urban (dhe pse të paaprovuar akoma). Logjika themelore e këtij plani është që të ofrojë shërbime jo vetëm për bashkinë e Manzës (duke qënë se nuk ka popullatën e nevojshme apo veprimtarinë ekonomike), por dhe për Durrësin, Ishmin, Rashbullin, Katundin e Ri.

Një nga projektet e identifikuara në Planin e Zhvillimit Urban është krijimi i Zonës së Kompleksit Sportiv Multi-Sport. Kjo zonë do t'i shërbejë kohezionit social dhe zhvillimit rinor në Manzë, Ishëm, Katund të Ri dhe në njësi të tjera limitrofe.

Qëllimi/et specifik të projektit

Qëllimi i projektit është rritja e gamës së mundësisë së argëtimit sportiv për të përmirësuar nivelin dhe cilësinë e ofrimit të tyre për banorët e Manzës, Ishmit (pushuesit e Gjirit të Lalzit), Katundit të Ri, etj.. Aktivitetet sportive do të kontribuojnë në rritjen e lidhjeve mes të rinjve të Bashkisë së re Durrës. Po ashtu, për pushuesit e Gjirit të Lalzit do të ofrohen shërbime cilësore që do të ndikojnë në rritjen e të ardhurave të zonës.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Rezultatet e pritshme përfshijnë:

- (a) pasurimi i gamës së argëtimit për banorët e zonës (Manzë, Ishëm, Katund i Ri, etj.);
- (b) përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për pushuesit e Gjirit të Lalzit;
- (c) rritja e nivelit të interesit të popullatës për të kaluar pushimet në Gjirin e Lalzit dhe rritja e numrit të pushuesve;
- (d) rritja e të ardhurave nga aktivitetet sportive.

PROJEKTI 8



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

Kohëzgjatja e përafërt për zbatimin e projektit është 12 muaj.

Aktivitetet e parashikuara përfshijnë:

- (a) vlerësimi i nevojave dhe planifikimi i ndërhyrjes, fillimisht me investime minimale (futboll / basketboll / tenis);
- (b) tenderimi, kontraktimi, zbatimimi i punimeve;
- (c) promovimi në zonë.

Maturimi i projektit

Aktualisht nuk evidentohet kryerja e ndonjë studimi fizibiliteti.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Burim i mundshëm financimi janë fondet publike të Bashkisë së Re Durrës, ose fondet publike-private.

Kostot e projektit

Kostoja e projektit vlerësohet të jetë 35,000 Euro.